

**V E N D I M****Nr. 824, datë 23.11.2016****P Ë R****PËRCAKTIMIN E FORMATIT E TË SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË VULAVE TË VERIFIKIMIT KUFITAR DHE TË RREGULLAVE TË VENDOSJES SË TYRE NË DOKUMENTET E UDHËTIMIT GJATË HYRJE-DALJEVE NË KUFIRIN SHTETËROR<sup>1</sup>**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 16, të ligjit nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Vulat që përdoren nga rojat kufitare, për efekt të verifikimeve kufitare në hyrje dhe në dalje të kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë, në vijim të këtij vendimi “vulat e hyrje-daljes”, kategorizohen si mall me natyrë të veçantë dhe prokurohen në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.
2. Trupi dhe gjurma e vulave të hyrje-daljes është prej materiali metalik, i cili i reziston përdorimit të shpeshtë dhe për një kohë të gjatë.
3. Trupi i vulave të hyrje-daljes përmban mekanizëm të lëvizshëm, që mundëson ndërrimin e datarit dhe të kodit të sigurisë.
4. Specifikimet e gjurmës së vulave të hyrje-daljes klasifikohen “konfidenciale”.
5. Gjurma e vulave të hyrje-daljes përmban kodin e personalizuar, emrin e pikës përkatëse të kalimit kufitar, simbolin përkatës të mjetit të udhëtimit, në varësi të

<sup>1</sup>Hyrë në fuqi më 02.12.2016; Faqe 24234 – 24236.

Ky vendim është përafruar pjesërisht me Rregulloren (BE) 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 9 mars 2016, “Mbi Kodin e Bashkimit Evropian që përcakton rregullat e regjimit të lëvizjes së personave përmes kufijve (Kodi i Kufijve Schengen)”, numri CELEX 32016R0399, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.77, datë 23.3.2016, faqe 1 – 52.

pikës së kalimit kufitar dhe në zonën ku vendosen shkronjat e simbolit të shtetit përmban simbolin “AL”, të rrethuar nga një rreth.

6. Mënyra e përcaktimit të kodit të sigurisë së vulave të hyrje-daljes për secilën pikë të kalimit kufitar, mënyra e magazinimit, e ruajtjes, e sigurimit dhe e dorëzimit të vulave, për secilin turn dhe roja kufitare në pikat e kalimit kufitar, si dhe formati i informacionit në lidhje me vulat e hyrje-daljes të dëmtuara, të humbura apo të vjedhura, rregullohen në Procedurat Standarde të Punës së Policisë Kufitare dhe Migracionit.
7. Kodi i sigurisë së vulave të hyrje-daljes ndërrohet në intervale të rregullta, jo më të gjata se një muaj.
8. Me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit përcaktohet një Pikë Kombëtare Kontakti, përgjegjëse për shkëmbimin e informacionit për kodet e sigurisë së vulave të hyrje-daljes. Pika Kombëtare e Kontaktit ka akses të menjëhershëm në informacionin për këto vula dhe, veçanërisht, për:
  - a. pikën e kalimit kufitar, në të cilën është dorëzuar një vulë e caktuar, dhe gjendjen fizike të saj;
  - b. identitetin e rojës kufitare, të cilit i është dhënë në dorëzim një vulë e caktuar, në një kohë të caktuar;
  - c. kodin e sigurisë së një vuletë caktuar, në një kohë të caktuar.
9. Kërkimi i informacionit për vulat e hyrje-daljes, në përputhje me parashikimet e pikës 8, të këtij vendimi, kryhet nëpërmjet Pikës Kombëtare të Kontaktit.
10. Vulosja e pasaportës që nuk përmban vizë kryhet duke vendosur vulën e hyrjes në anën e majtë të faqes së parë të lirshme të pasaportës, duke filluar nga lart. Vula e daljes vendoset, parimisht, në të njëjtën faqe, përbri vulës së hyrjes.
11. Vulosja e pasaportës që ka një vizë, me të cilën personit i jepet e drejta e hyrjes, kryhet sipas parashikimit të pikës 10, të këtij vendimi, por vulosja fillon në faqen përballë faqes ku është vendosur viza. Nëse kjo faqe është e zënë, vulosja kryhet në faqen e lirë vijuese.
12. Vulat e hyrje-daljes në pasaportë nuk vendosen në faqet në të cilat pasqyrohen ose kërkohen shënime të tjera dhe në zonën e lexueshme nga aparaturat.
13. Në dokumentet e tjera, që janë përcaktuar për t'u vulosur, sipas ligjit nr.71/2016, “Për kontrollin kufitar”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, vulat e hyrje-daljes vendosen në hapësirën e posaçme për vulosje ose në një pjesë të dukshme të dokumentit, kur nuk ka një hapësirë të tillë të posaçme.
14. Në rastet e refuzimit të hyrjes, në faqen e parë të lirshme të pasaportës vendoset një vulë hyrjeje, e cila anulohet me një kryq, që shkruhet me bojë që nuk del, siç

tregohet në shtojcën 1/a, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e tij këtij vendimi, dhe përbri saj, në anën e dorës së djathtë, po me këtë lloj boje shënohet shkronja ose shkronjat korresponduese për refuzimin e hyrjes, sipas formularit të refuzimit të hyrjes.


15. Kur vula e hyrjes ose e daljes vendoset gabimisht në një dokument apo paraqet të dhëna jo të sakta, ajo revokohet me dy viza paralele, me bojë që nuk del, të vendosura në këndin e sipërm të vulës, në anën e dorës së majtë, siç tregohet në shtojcën 1/b, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
16. Personat që kanë hyrë ose kanë dalë në mënyrë të ligjshme, por të cilëve u mungon vula në dokumentin e udhëtimit apo shënimet zyrtare përkatëse në sistemet elektronike, pajisen me formularin që vërteton hyrjen ose daljen e ligjshme, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, nga struktura e Policisë Kufitare dhe të Migracionit që evidenton e para rastin. Kjo strukturë kryen verifikimin e ligjshmërisë së hyrjes ose daljes së personit me anë të dokumenteve ndihmëse, si: bileta udhëtimi, lista udhëtarësh, shënime të tjera zyrtare, arkiva të ndryshme, etj., dhe bën, gjithashtu, shënimin për datën, vendin dhe drejtimin e kalimit të kufirit në dokumentin e udhëtimit të personit.
17. Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin, në bazë të nevojave të secilës pikë kalimi kufitar, harton listën e plotë të kërkesës për vula hyrjeje dhe daljeje, duke përfshirë kodet e personalizuara dhe simbolet përkatëse të mjetit të transportit për secilën vulë.
18. Vulat e nxjerra jashtë përdorimit ruhen dhe administrohen sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr.9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”.
19. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**


**EDI RAMA**

**Shtojca 1/a** - Anulimi i vulës së hyrjes



(F)

**Shtojca 1/b** - Revokimi i vulës së hyrjes/daljes



**Shtojca 2 : Formulari që zëvendëson mungesën e vulës ose shënimit zyrtar të hyrjes / daljes**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Drejtoria e Policisë së Shtetit  
Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin  
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin \_\_\_\_\_  
Sektori / Seksioni / Pika e Kalimit Kufitar \_\_\_\_\_

MIRATIM I DËSHMIVE / PROVAVE PËR RESPEKTIMIN E KUSHTEVE TË QENDRIMIT AFATSHKURTËR NË RASTET KUR DOKUMENTI I UDHËTIMIT TË TË HUAJIT NUK MBART VULË HYRJEJE / DALJEJE OSE KUR NË SISTEMIN ELEKTRONIK TË PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE NUK KA SHËNIME ZYRTARE PËR HYRJEN / DALJEN E TË HUAJIT.

APPROVAL OF THE EVIDENCE REGARDING THE RESPECT OF THE CONDITION OF THE DURATION OF A SHORT STAY IN CASES ËHERE THE TRAVEL DOCUMENT OF THE ALIEN DOES NOT BEAR AN ENTRY / EXIT STAMP OR ËHEN THERE IS NOT ANY OFFICIAL RECORD OF ENTRY / EXIT IN THE ELECTRONIC DATA PROCESSING SYSTEM CONCERNING THE ALIEN.

Më \_\_\_\_\_, në orën \_\_\_\_\_, në (vendi) \_\_\_\_\_,  
On \_\_\_\_\_, at (time) \_\_\_\_\_, at (place) \_\_\_\_\_,  
autoriteti nënshkrues \_\_\_\_\_ ka present:  
we, the undersigning authority, \_\_\_\_\_ have before us:  
(mbiemri) \_\_\_\_\_ (emri) \_\_\_\_\_  
(surname) \_\_\_\_\_ (first name) \_\_\_\_\_  
lindur më \_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_, të gjinisë \_\_\_\_\_  
date of birth \_\_\_\_\_, place of birth \_\_\_\_\_, sex \_\_\_\_\_  
me shtetësi \_\_\_\_\_, banues në \_\_\_\_\_  
nationality \_\_\_\_\_, resident in \_\_\_\_\_  
me dokument udhëtimi \_\_\_\_\_, numër \_\_\_\_\_  
travel document \_\_\_\_\_, number \_\_\_\_\_  
lëshuar në \_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_  
issued in \_\_\_\_\_, on \_\_\_\_\_  
me numër vize (nëse është e zbatueshme) \_\_\_\_\_, lëshuar nga \_\_\_\_\_  
visa number (if applicable) \_\_\_\_\_, issued by \_\_\_\_\_  
me afat \_\_\_\_\_ ditor, me motivin:  
for a period of \_\_\_\_\_ days, on the following grounds: \_\_\_\_\_.

Duke marrë parasysh provat që ka paraqitur lidhur me qëndrimin e tij / saj në territorin, konsiderohet se ka hyrë në / dalë nga RSH më \_\_\_\_\_, ora \_\_\_\_\_, Pika e Kalimit Kufitar \_\_\_\_\_.

Having regard to the evidence relating to the duration of his/her stay on the territory, that he / she has provided is considered to have entered / left the territory of the Republic of Albania on \_\_\_\_\_, at \_\_\_\_\_, at the border crossing point \_\_\_\_\_.

Të dhënat e kontaktit të autoritetit nënshkrues:

Contact details of the undersigning authority:

Tel: \_\_\_\_\_

Fax: \_\_\_\_\_

e-mail: \_\_\_\_\_

Personi i interesuar pajiset me një kopje të këtij dokumenti

The person concerned shall receive a copy of this document

Personi i interesuar  
Person concerned

Oficeri i autorizuar  
Officer responsible